Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMUNA E PODUJEVËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT - DSHPMSH

Mbështetur në nenin 13 paragrafi 1.1 dhe 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f), dhe 40.2 shkronjat a), g) si dhe nenin 62 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 8 shkronja a) dhe 15 shkronja f) të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, dispozitave të nenit 15 (me theks paragrafi 1.8) dhe dispozitave të nenit 34 të Ligjit për mbeturina nr.04/L-060, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/L-071, si dhe neneve 14, 15 paragrafi 2.3, 11 paragrafi 1.11, dhe 34 paragrafi 2.1, 2.7, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe duke u bazuar në nenet 5 paragrafi 14 dhe dispozitave të nenit 7 (me theks paragrafët 8, 9 dhe 10) të Rregullores Komunale nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës,

PROPOZOHET KJO;

RREGULLORE

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019, për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.prot.01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020 dhe Rregulloren nr.prot.01-352/11-0045227/21 të datës 04 qershor 2021

Neni 1

Me këtë Rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja (bazë) nr.prot.01-352/11-0084561/19 e datës 30 tetor 2019 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës, përkatësisht shtojca e Rregullores ku është paraparë kategorizimit të konsumatorëve komercial dhe industrial si dhe lartësia e taksës (tarifës) për menaxhimin e mbeturinave, dhe atë si në vijim;

Kategorizimi i Konsumatorëve Komercial / Industrial			
Shërbimet e ofruara me kontejnerë të përbashkët			
Nënkategoria 1 "Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese"	Nënkategoria 2 "Subjektet e mesme deri të mëdha komerciale/industriale me kosto të ulët të shërbimit"	Nënkategoria 3 "Subjektet e mesme deri të mëdha Komerciale / Industriale me kosto të moderuar të shërbimit"	Nënkategoria 4 "Konsumatorët me kontrata të veçanta për zbrazje"
Kioska; Kafe-pjekëse; Shitës të CD-ve dhe Kasetave; Argjendari; Ortarë; Agjenci Turistike; Avokatura; Video-lojëra; Video-Klube; Internet-Kafe; Rrobaqepës; Këpucëtar; Dyqane Fotografish; Pastrim Kimik; Kozmetika; Optika; Gur-gdhendës; Saraç-Mbathtarë; Zyra të Inkasimit; OJQ-të; Shitore Suvenirësh; Këmbimore; Autoparkingje; Butiqet; Libraritë; Llamarinë-punuesit; Axhustatorët, dhe veprimtaritë e ngjashme.	Auto-Larjet; Kurse të gjuhëve dhe TI-së; Frizerë për meshkuj dhe femra; Ëmbëltore; Shitore Tekstili; Shitore të Auto-Pjesëve; Hekurishte; Shitore Sanitare; Shitore të Mobiljeve, Shitore Këpucësh; Servise të Ndryshme; (elektroteknike dhe TI); Objektet Fetare; Zyra të Partive Politike; Farmacitë; Zyrat Postare; Bastoret; Ordinancat Private; Ordinaca Stomatologjike; Automekanikë; Autoelektricistë; Autosaldues; Autosallone dhe veprimtari të ngjashme	Furrat e Bukës; Furra të Bukës dhe Byrektoret; Kafiteritë; Shitoret Ushqimore; Bodrume të Pijeve; Poliklinikat; Filiale të Bankave; Sallone të Sanitarisë; Sallone Mobiljesh; Qendra Sportive; Qendra të Fitnesit; Fast Food; Pompat e Derivateve; Xhamë-Prerësit; Gjellëtoret; Restorantet; Fast- Food-Restorante; Diskotekat; Motelet; Pompate derivateve me Restorante, dhe veprimtari të ngjashme	Stadiumet; Qendrat Tregtare; Fushat e Sportit; dhe Konsumtatorët e nënkategorisë 4 me sasi të mëdha të mbeturinave të gjeneruara.

Lartësia e Taksës (Tarifës) për Menaxhimin e Mbeturinave

	Urban				Rural			
	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara		Ngritje % (zbritje)	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara		Ngritje % (zbritje)
		Pa TVSH	Me TVSH			Pa TVSH	Me TVSH	
I. Amviseritë								
Amviseritë	4.35	6.36	7.50	72.41%	4.35	6.36	7.50	72.41%
II. Komercial/Industrial								
Dyqanet e vogla dhe industriale	7.03	8.47	10.00	42.25%	5.3	6.44	7.60	43.40%
Bizneset e mesme deri te medha me kosto te ulet te sherbimit	10.6	13.56	16.00	50.94%	6.3	8.05	9.50	50.79%
Bizneset e mesme deri te medha me kostote moderuar te sherbimit	17.22	20.00	23.60	37.05%	11.5	12.97	15.30	33.04%
Bizneset e mesme deri te medha me kosto te lartë te sherbimit	17.22	25.16	29.69	72.41%	11.5	16.80	19.83	72.41%
Bizneset me kontrate - 1.1 m3	9.74	14.23	16.79	72.41%	9.74	14.23	16.79	72.41%
Bizneset me kontrate - 5.1 m3								
Bizneset me kontrate - 7.1 m3	37.8	55.23	65.17	72.41%	37.8	55.23	65.17	72.41%
III.Institucionet								
Institucionet me kontratë - 1.1 m3	9.74	14.23	16.79	72.41%	9.7	14.17	16.72	72.41%
Institucionet me kontratë - 5.1 m3								
Institucionet me kontratë - 7.1 m3	37.8	55.23	65.17	72.41%	37.8	55.23	65.17	72.41%

Neni 2

Ndryshimi dhe plotësimi sipas nenit 1, përkatësisht ndryshimi i shtojcës së Rregullores bazë ku është paraparë kategorizimit të konsumatorëve komercial dhe industrial si dhe lartësia e taksës / tarifës për menaxhimin e mbeturinave, bëhet pas rishikimit shkallës së Taksës / Tarifës së menaxhimit të mbeturinave nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit pas kërkesave të Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave KRM "Pastrimi" me arsyetimin e rritjes së kostos së shërbimit si dhe në funksion të mbulimit të të gjitha shpenzimeve të grumbullimit dhe transportit si dhe kostove tjera operative për të siguruar një shërbim cilësorë dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e Rregullores bazë me nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren nr.prot.01-352/04-0023112/20 të datës 22 maj 2020, dhe Rregulloren nr.prot.01-352/11-0045227/21 të datës 04 qershor 2021.

Neni 4

1. Pas miratimit, kjo Rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

2. Zbatimi i kësaj Rregulloreje fillon nga data 01 janar 2027.

3.Me fillimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet shtojca: Kategorizimi i Konsumatorëve Komercial / Industrial dhe Lartësia e taksës / tarifës për menaxhimin e mbeturinave i Rregullores bazë nr.prot.01-352/11-0084561/19 të datës 30 tetor 2019.

Podujevë,
23. 11. 2026

Bahri Selimi
Drejtor i DSHPMSH

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA PODUJEVË - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË/O